



PROJEKT ZBATIMI

RAPORT TEKNIK

OBJEKTI:

STUDIM-PROJEKTIM:

**“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS NË FSHATIN ÇIZMELI,
BASHKIA SHIJAK”**

PROJEKTUES:

BASHKIA SHIJAK

Qarku: **Durrës**

NjVV: **Bashkia Shijak**

Emertimi i Objektit: **“Rikonstruksioni i rrugës në fshatin Çizmeli, Bashkia Shijak”. L= 3600ml.**

RAPORTI TEKNIK

Lenda: Mbi gjendjen ekzistuese dhe mënyren e ndërhyrjes në këtë aks rrugor.

➤ Të përgjithshme



Objekti hartim Projekt-Zbatimi: “Rikonstruksioni i rrugës fshati Çizmeli, Bashkia Shijak”
ndodhet ndodhet në Njësinë Administrative Gjepalaj. Rruga ka një gjatësi rreth 3600 ml dhe një gjerësi 3-5 ml. Zona ku shtrihet rruga është një zone kodrinore dhe fushore, perbere me banesa private, mure rrethuese, toka bujqesore dhe me një popullsi me dëndësi jo shume te larte.

Gjatësia e rrugës: $L=3600\text{ml}$

Gjerësia e rrugës ekzistuese: $L= 3\text{-}5\text{ml}$

➤ **Gjendja Ekzistuese**


Rruga ka mungesë të plotë infrastrukture. Ajo është me bazament me çakëll por me trup të rrugës shumë të dëmtuar dhe mjaft i vështirë për tu kaluar nga atomjetet. Duke marre shkas nga nevoja qe ka ky komunitet per investimin e kesaj rruge dhe kerkeses se vazhdueshme nga ana e tyre, si dhe prioritetin qe ka ky segment rrugor per sa i perket lidhjes me qytetin e Tiranës, eshte hartuar projekt buxheti per investimin ne rikonstruksionin e kesaj rruge. Ne keto kushte u moren te gjitha masat dhe veprimet per hartimin dhe konkretisht bënë matjet topografike, fotografimi dhe inspektimi ne terren i gjendjes ekzistuese të cilën do ta pasqyrojme më poshtë përmes fotove. Sic vihet re ne fotot e mëposhtme janë bërë këto konstatime: Rruga ka mungesë të plotë infrastrukturë. Ajo është me bazament me çakëll por me trup të rrugës shumë të dëmtuar dhe mjaft i vështirë për tu kaluar nga atomjetet. Realizimi i ketij projekti do te behet mbi bazen e standarteve dhe kushteve teknike Shqiptare. Projekt zbatimi per objektin: ”Rikonstruksioni i rrugës fshati Çizmeli, Bashkia Shijak”.

➤ **Pozicioni dhe Vendodhja e Objektivit**

Objekti hartim Projekt-Zbatimi: “Rikonstruksioni i rrugës fshati Çizmeli, Bashkia Shijak”
ndodhet ndodhet në Njësinë Administrative Gjepalaj. Rruga paraqitet në gjendje të amortizuar pa asnjë parametër inxhinierik, ku ka mungesë të të gjitha elementeve përbërës të saj duke perfs hire shtresat rrugore, kanalizimet, sinjalistiket dhe sigurine. Zona ku shtrihet rruga është një zone kodrinore dhe fushore, perbere me banesa private dhe me një popullsi me dëndësi te konsiderueshme.

➤ Përshkrimi Fizio-Gjeografik i zonës

Baza gjeodezike e krijuar është shumë e rendesishme që të ruhet e paprekur dhe e pa demtuar edhe gjatë procesit të ndertimit në mënyrë që të sigurohet ekzekutimi i proceseve të punës me saktësinë e duhur. Koordinatat (X;Y) janë absolute sipas projeksionit UTM/WGS84, ndërsa kuotat janë matur referuar Gjeoidit EGM96 të cilat jepen me poshtë me monografite respektive:



PLANIMETRIA E PERGJITHESHME E RILEVIMIT ME STACIONET TOPOGRAFIKE.

➤ **Foto gjatë procesit te vizites në terren**








➤ **Menyra e Nderhyrjes**

Duke analizuar gjendjes ekzistuese dhe nevojën që ka rruga është parashikuar nderhyrja në të gjithë gjatësinë e saj prej 3660m. Parametrat e rrugës pas investimit do të jenë karexhata me një gjerësi prej 4m asfalt dhe 0.5m bankine në të dyja anët e saj. Në të gjithë gjatësinë e rrugës janë parashikuar kanalet kulluese dhe kanalet drenazhuese anësore, nga ku në pjesën e banuar këto kanale do të jenë betoni që parashikohet kanal i mbuluar me soletë betoni në të gjitha hyrjet-daljet e shtepiave. Në pjesët ku nuk ka objekte banimi është parashikuar kanal i hapur dheu. Në pjesën fundore të rrugës e cila ka një terren relativisht malor të pjerret, ku pjerresia në segmente të caktuara kalon mbi 15%, është parashikuar që trupi i rrugës të bëhet me beton të armuar. Gjithashtu në këtë segment është parashikuar dhe ndërtimi i mureve prites si nevojë për mbajtjen e ledheve të tokave që janë përbri rrugës. Për garantimin e largimit të ujrave në të gjithë gjatësinë e rrugës janë parashikuar vepra arti tombino me diametër nga 600-1500. Pjesa fundore e rrugës që është edhe zonë e banuar është parashikuar ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të bardha me tub të brinjezuar 400, duke bërë të mundur dhe gjithë kullimet që vijnë nga objektet e banimit, për të cilat janë ndërtuar puseta kontrolli çdo 30m përgjatë gjithë gjatësisë të nevojshme. Paketa e rrugës është parashikuar me 20cm çakell guror, stabilizant 10cm, binder 6cm dhe asfaltobeton 4cm. Po ashtu në segmentet që paraqiten me prezencë lageshtire është parashikuar ndërtimi i një drenazhi në trupin e rrugës, duke parashikuar mbushje me gur kave 40-60cm në mënyrë që të garantohet largimi i ujrave poshtë shtresave rrugore. Muret prites që do të ndërtohen janë parashikuar mure betoni me gravitet me lartësi që varion nga 1.5-2m.


SEKSIONI TIP 1
Aplikohet në Progresivat:

0+000.00–0+006.00




SEKSIONI TIP 2
Aplikohet në Progresivat:

0+006.00–0+075.00
0+475.00–1+717.62




SEKSIONI TIP 3
Aplikohet në Progresivat:

0+075.00–0+475.00




SEKSIONI TIP 4
Aplikohet në Progresivat:

1+717.62–2+025.00




SEKSIONI TIP 5
Aplikohet në Progresivat:


2+450.00–3+025.00



SEKSIONI TIP 6
Aplikohet në Progresivat:


3+025.00–3+100.00






SEKSIONI TIP 9
Aplikohet në Progresivat:

2+025.00–2+050.00




SEKSIONI TIP 10
Aplikohet në Progresivat:

2+050.00–2+400.00



SEKSIONI TIP 11
Aplikohet në Progresivat:

2+400.00–2+450.00



Shenim: Shiko Profilet Tip dhe Planimetrine per llojin e ndërhyrjes.

➤ **Organizimi I punimeve dhe preventive**

Te gjitha punimet jane parashikuar te kryhen ne perputhje me specifikimet teknike qe i bashkengjiten ketij projekti. Ne preventivin e punimeve jane parashikuar te gjithe zerat e punimeve te keti projekti, me çmimet e manualit te Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit te qe jane ne fuqi. Per zera te vecante jane hartuar analiza cmimesh.

➤ **Konkluzione**

Rikonstruksioni i rrugës ” Rikonstruksioni i rrugës fshati Çizmeli, Bashkia Shijak”, paraqet mjaft interes në rritjen e mirëqënies së komunitetit në përgjithësi që banon në këtë rrugë,dhe në mbarë komunitetin në tërësi. Rruga e projektuar ruan përgjithësisht gjurmën e rrugës ekzistuese. Kjo zgjidhje është bërë me synimin për të ruajtur në maksimum objektet e banimit duke ruajtur objektivin që në një të ardhme të afërt kjo zonë të zgjerohet sipas planit të ri rregullues, dhe zgjerimi e drejtimi i rrugëve të mos jetë objekt prishje dhe shpronësimesh por i zhvillimit të zonës. Trajtimi i këtyre rrugëve, me tërë elementet e infrastrukturës rrugore dhe të atyre inxhinierike, do të bëjë që ata të funksionojnë mirë në tërë drejtimet, duke i shërbyer komunitetit me tërë komponentet e nevojshëm jetësore. Një pjesë e këtyre rrugëve janë lënë pas dore për vite e vite me radhë. Rehabilitimi i tyre do të bëjë që cilësia e jetës në to të ndryshojë rrënjësisht.
